



## Këshilli i Sigurimit

Distr.: I përgjithshëm  
30 korrik 2018

Origjinali: Anglisht

### Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

#### Raport i Sekretarit të Përgjithshëm

#### I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit

1. Ky raport parashtrohet në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit [1244 \(1999\)](#), përmes së cilës Këshilli krijoi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe kërkoi nga unë që të raportoj në intervale të rregullta për zbatimin e mandatit të tij. Në raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 prill deri më 15 korrik 2018.

2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë e regjion. Në çuarjen përpara të objektivave të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe me palët regjionale e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë të kryejnë rolet e tyre në brenda kornizës së Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit [1244 \(1999\)](#). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 ([S/PRST/2008/44](#)) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 ([S/2008/692](#)). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara bashkëpunojnë ngushtë me Misionin.

#### II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Gjendja e përgjithshme gjatë periudhës raportuese ka mbetur stabile, për dallim prej periudhës paraprake raportuese ku disa zhvillime patën ndikim negativ në marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës. Në përputhje me deklaratën e bërë nga partia Lista Serbe për Kosovë e Metohi pas arrestimit dhe dëbimit nga Kosova të drejtorit të Zyrës për Kosovë e Metohi të Qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriq, më 26 mars, ministrat dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës nga Lista Serbe vazhduan mospjesëmarrjen e tyre në sesionet formale të Qeverisë apo të Kuvendit, si dhe protestimin për vonesën e themelimit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Në ndërkohë, partitë shqiptare të Kosovës të koalicionit qeverisës dhe ato të opozitës u përqendruan në pozitën e Prishtinës në kuadër të dialogut me Beogradin të mbështetur nga Bashkimi Evropian, i cili rifilloi më 24 qershor.



Diskutimet vazhduan si në Kuvend të Kosovës, ashtu edhe jashtë tij lidhur me përbërjen dhe strategjinë e ekipit negociator të Prishtinës, me ç’rast Kuvendi dhe kryeministri dorëzuan propozime të ndryshme për shqyrtim. Kryeministri, Ramush Haradinaj, e dorëzoi propozimin e tij më 10 prill, ndërsa kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, më 23 prill.

4. Disa incidente gjatë periudhës së raportimit treguan potencialin për ripërtëritje të tensioneve. Më 17 maj në komunën e Ferizajt zyrtarët e Kishës Ortodokse Serbe raportuan dëmtime të kishave në dy incidente të ndara. Më 26 maj kanë filluar ndërtimet në rrugën e transitit brenda zonës së posaçme të mbrojtur të manastirit të Deçanit – vend i trashëgimisë botërore i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Kisha Ortodokse Serbe lëshoi një komunikatë, ku theksohet se punët ndërtimore shkelin Ligjin e Kosovës për zonat e posaçme të mbrojtura dhe janë në kundërshtim me konkluzionet e Këshillit për zbatim dhe monitorim, i cili mbikëqyrë zonat e posaçme të mbrojtura përreth lokacioneve fetare. Lista Serbe, ministri i Kosovës për Komunitete dhe Kthime nga Lista Serbe, Zyra për Kosovë e Metohi e Qeverisë së Serbisë dhe grupet e shoqërisë civile të serbëve të Kosovës gjithashtu protestuan kundër punimeve të rrugës. Bashkësia ndërkombëtare reagoi njëzëri dhe, pas konsultimeve me kryetarin e komunës së Deçanit, rekomandoi pezullimin e punëve brenda zonës së posaçme të mbrojtur. Kryeministri i Kosovës, ministri i Infrastrukturës i Kosovës dhe kryetari i komunës së Deçanit sqaruan se punët do të vazhdonin në një largësi prej 5 km nga zona e posaçme e mbrojtur. Pas një pauze tremujore, Këshilli për zbatim dhe monitorim u takua më 10 korrik për të diskutuar çështjen e punëve ndërtimore dhe u pajtua që së shpejti të vizitoj vendin së bashku me kryeministrin.

5. Në një incident të ndarë, më 28 maj, rreth 60 shqiptarë organizuan një protestë në komunën e Klinës për t’i parandaluar 30 besimtarë serbë të Kosovës që të marrin pjesë në festivalin ortodoks “Shën Trinia” afër gërmadhëve të kishës ortodokse serbe të Shën Trinisë. Policia e Kosovës ndërhyri kur disa protestues hodhën gurë drejt besimtarëve, duke u shkaktuar lëndime të rënda njërit besimtar dhe lëndime të lehta dy të tjerëve. Më 30 maj në komunën e Lipjanit, një shqiptar i ri ngacmoi me fjalë dhe sulmoi fizikisht një mashkull serb, i cili ndërhyri për të ndaluar një grup të të miturve shqiptarë që ngacmonin fëmijët serbë në një shesh lojërash. Ministri i Kosovës për Komunitete dhe Kthime nga Lista Serbe dënoi të dy incidentet dhe kërkoi nga Policia e Kosovës që t’i sjell fajtorët para drejtësisë. Disa ditë më vonë, përderisa hetimet vazhdonin, zyrtarët vendorë dhe udhëheqësit e komunitetit në komunën e Lipjanit nisën një proces të ndërmjetësimit që ndihmoi në rënien e tensioneve. Nga data 28 maj deri më 1 qershor, qendra shëndetësore e udhëhequr nga Qeveria e Serbisë në fshatin etnikisht të përzier të Suhodollit të Poshtëm në Mitrovicë të Veriut është dëmtuar në tri incidente të ndara të gjuajtjes me gurë.

6. Lidhur me incidentet e lartpërmendura, më 3 qershor, Lista Serbe lëshoi një komunikatë ku dënonte sulmet e fundit kundër serbëve dhe pronave të tyre, dhe pretendoi se në muajin maj kishin ndodhur 16 incidente të motivuara etnikisht kundër serbëve. Më 5 qershor, Zyra e Kryeministrit të Kosovës nxori një komunikatë, përmes së cilës dënonte incidentet e fundit me “motive ndëretnike” që kanë ndikim negativ në marrëdhëniet mes komuniteteve në Kosovë, dhe kërkoi që fajtorët të sillen para drejtësisë. Kryetari i Kosovës, Hashim Thaçi, bëri deklaratatë të ngjashme publike. Në një deklaratë të lëshuar më 6 qershor, Përfaqësuesi im Special për Kosovë, Zahir Tanin, mirëpriti këto deklaratatë, duke theksuar se “në një shoqëri demokratike nuk ka vend për ngacmime”.

7. Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës vazhdoi të kërkoj transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në forcë të armatosur, ndërsa udhëheqësia e Serbisë e kundërshton fuqishëm atë. Më 28 prill, një pjesëtar serb i Forcës së Sigurisë së Kosovës është arrestuar dhe marrë në pyetje nga policia e Serbisë në Portën 5 në

vendkalimin Konçul të vijës administrative kufitare. Kryeministri i Kosovës ka shprehur shqetësimin për këtë incident, duke theksuar se i njëjti shkonte në dëm të përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për integrimin e komunitetit serb. Më 27 maj, automjetit të një pjesëtari tjetër serb të Forcës së Sigurisë së Kosovës i është vënë flaka në komunën e Zubin Potokut, në veri të Kosovës. Më 10 korrik, policia e Kosovës arrestoi dhe liroi më vonë gjatë ditës pesë serbë të Kosovës në regjionin e Gjilanit, për të cilët pretendohet se kishin lidhje me vendimin e 47 pjesëtarëve serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga regjioni i Gjilanit për të dhënë dorëheqje nga Forca në fillim të korrikut. Të njëjtën ditë, drejtori i Zyrës për Kosovë e Metohi të Qeverisë së Serbisë ka dënuar arrestimet gjatë një konference të paplanifikuar për media, siç bëri edhe Lista Serbe, e cila gjithashtu akuzoi policinë e Kosovës për përdorim joproporcional të forcës, dhe ftoi serbët e Kosovës që të mos i bashkohen Forcës së Sigurisë së Kosovës.

8. Më 17 maj, kryetari i Kosovës, kryeministri i Kosovës dhe zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, morën pjesë në samitin e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor në Sofje. Në përfundim të samitit, Bashkimi Evropian miratoi një deklaratë ku rikonfirmoi “përkrahjen e palëkundur” për perspektivën evropiane të regjionit dhe nënvizoi një numër masash që duhet të realizohen nga qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të përmirësuar lidhshmërinë infrastrukturore, sigurinë dhe sundimin e ligjit në regjion. Më 10 korrik, shefat e qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerët nga Ballkani Perëndimor u takuan në Londër në kuadër të procesit të Berlinit. Në përfundim të takimit, të gjithë pjesëmarrësit e procesit nënshkruan deklaratat e përbashkëta për bashkëpunim regjional dhe marrëdhënie të mira fqinjësore, për çështjen e krimeve të luftës dhe për persona të zhdukur.

9. Më 15 qershor, pas vendimit të Këshillit të Evropës dhe këmbimit të letrave mes kryetarit të Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Federica Mogherini, EULEX-i filloi me mandatin e ri më të kufizuar dyvjeçar, me një staf të reduktuar prej 503 vetash, që do të arrihet pas procesit të rikonfigurimit, in cili përfundon më 14 dhjetor. Derisa gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it më nuk kanë funksione ekzekutive në sistemin gjyqësor të Kosovës, EULEX-i do të monitoron lëndët e përzgjedhura penale dhe civile, si dhe do të vazhdojë monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës. EULEX-i gjithashtu do të jep përkrahje operationale në zbatimin e marrëveshjeve të arritura brenda kornizës së dialogut të mbështetur nga BE-ja mes Beogradit dhe Prishtinës, si dhe do të mbajë rolin e vet si reagues i dytë i sigurisë.

10. Në përputhje me kriteret e liberalizimit të vizave për Kosovën, të përcaktuara nga Komisioni Evropian, autoritetet e Kosovës kanë promovuar zbatimin e masave për luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Qeveria e Kosovës po ashtu ka vazhduar të zbatojë reformat e parapara në kuadër të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, duke përfshirë reformën e sektorit të administratës publike.

11. Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur raste të raportuara të luftëtarëve që dyshohen të jenë nisur nga Kosova për Irak dhe (ose) Republikën Arabe të Sirisë. Megjithatë, kthimi i luftëtarëve të huaj nga zonat e konfliktit vazhdoi të jetë objekt shqetësimi në mbarë regjionin. Gjatë periudhës raportuese, janë shpallur disa gjykime lidhur me rastet e terrorizimit. Më 18 maj, gjykata themelore e Prishtinës dënoi nëntë individë për planifikimin e sulmeve terroriste gjatë ndeshjes së futbollit mes Shqipërisë dhe Izraelit në vitin 2016, duke shqiptuar dënime prej 18 muaj deri në 10 vjet burgim. Më të njëjtën datë, për shkak të mungesës së provave dhe dëshmimeve, gjykata themelore e Prishtinës liroi nga akuza pesë imamë, të cilët akuzoheshin për nxitje të akteve terroriste. Më 8 qershor, gjykata themelore e Prishtinës urdhëroi arrestimin e dy individëve që dyshoheshin për organizimin e sulmeve terroriste në

Kosovë (njëri kundër Forcës së Kosovës - KFOR dhe tjetri kundër qytetarëve të rëndomtë).

12. Përfaqësuesi im Special për Kosovë vazhdoi angazhimin e tij me udhëheqësit politikë në Prishtinë, Beograd dhe regjion. Kështu, më 7 qershor ai u takua me kryetarin e Kosovës në Prishtinë. Më 11, 12 dhe 14 qershor, së bashku me Ndihmëssekretaren e Përgjithshme për Operacione Paqeruajtëse, Bintou Keita, u takua me kryetarin e Serbisë, Alleksandar Vuçiq, dhe me zëvendëskryeministrin e parë e ministrin e Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiq, në Beograd. Ai po ashtu u takua me kryeministrin e Kosovës dhe me zëvendëskryeministrin e parë e ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, në Prishtinë, si dhe me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, në Tiranë.

### III. Kosova veriore

13. Kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut, i cili gjithashtu është edhe kryetar i Listës Serbe, në një deklaratë për media të dhënë më 12 prill, deklaroi se rihapja e e urës kryesore për trafik në Mitrovicë nuk mund të bëhet për shkak të gjendjes së sigurisë. Ai gjithashtu kërkoi nënshkrimin e shpejtë të memorandumit të mirëkuptimit për kufirin komunal mes Mitrovicës së Veriut dhe asaj të Jugut, ashtu siç parashihet në marrëveshjen e mbështetur nga Bashkimi Evropian të gushtit 2015 për rivitalizimin e urës kryesore. Si përgjigje ndaj kësaj kërkesë, kryetari i komunës së Mitrovicës së Jugut hodhi poshtë shqetësimet e sigurisë së homologut të tij dhe sugjeroj që Bashkimi Evropian të cakton një datë për rihapjen e urës.

14. Hetimet për vrasjen e 16 janarit të politikanit serb të Kosovës, Olliver Ivanoviç, në Mitrovicë të Veriut kanë mbetur të pazgjidhura. Më 16 prill, partia politike e z. Ivanoviç Nisma Qytetare "Serbia, Demokracia, Drejtësia", shprehu shqetësimin për mungesën e informatave rreth zhvillimit të hetimeve.

### IV. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës

15. Pas një pauze tremujore, më 24 qershor, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë ishte nikoqire në Bruksel e takimit të nivelit të lartë të dialogut të mbështetur nga Bashkimi Evropian me kryetarin e Serbisë dhe kryetarin e Kosovës. Pas takimit treorësh, në komunikatën e leshur nga Zyra e Përfaqësueses së Lartë, u tha që dy kryetarët kishin pasur "diskutim intensiv dhe të frytshëm lidhur me kornizën e marrëveshjes për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes dy palëve". Takimi i nivelit të lartë u parapri më 22 qershor nga takimi i ekipeve teknike të Beogradit dhe Prishtinës, të udhëhequra nga kryenegociatorët përkatës, z. Gjuriq dhe Avni Arifi.

16. Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë veçse ishte takuar me kryetarin e Serbisë dhe me kryetarin e Kosovës më 16 maj në margjinat e samitit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor në Sofje. Pas këtij takimi, Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme nxori një deklaratë ku u theksua se dy udhëheqësit kishin konfirmuar gatishmërinë e tyre për vazhdimin e punës intensive me Përfaqësuesen e Lartë me qëllim të arritjes së normalizimit gjithëpërfshirës të marrëdhënieve.

17. Dallimet mes Beogradit dhe Prishtinës lidhur me themelimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, ashtu siç parashihet sipas Marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve (Marrëveshja e Brukselit) e datës 19 prill 2013, vazhduan të pengojnë përparimin e dialogut të mbështetur nga Bashkimi Evropian. Më 18 prill, kryetari i Serbisë deklaroi

se serbët e Kosovës nuk do të formonin në mënyrë të njëanshme asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë ashtu siç ishte paraparë më herët si reagim ndaj vonesave të Prishtinës në ecurinë e themelimit të tij/saj. Në vend të kësaj ata u pajtuan të presin deri në fund të periudhës katërmujore të caktuar nga Prishtina si afat për hartimin e statutit të asociacionit/bashkësisë. Të nesërmen, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, pas takimeve të ndara me kryetarin e Serbisë dhe kryeministren e Serbisë, Ana Brnabić, në Beograd, theksoi rëndësinë e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve brenda kornizës së dialogut të mbështetur nga BE-ja.

18. Në ndërkohë, ekipi menaxhues që ka për detyrë hartimin e statutit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe ka mbajtur nëntë takime gjatë periudhës shqyrtuese, por nuk ka nxjerrë ndonjë raport për gjetjet apo përfundimet e tij.

## **V. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet e komuniteteve**

19. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) ka regjistruar 77 kthime vullnetare në Kosovë të qytetarëve nga radhët e komuniteteve joshumicë. Me këta të kthyer, gjithsej numri i qytetarëve të kthyer të komuniteteve joshumicë në Kosovë që nga viti 2000 ka arritur në 27,884. Aktualisht, UNHCR-ja raporton gjithsej numrin prej 89,480 personave të zhvendosur nga konflikti i viteve 1998–1999, nga të cilët 72,000 gjenden në Serbi, 16,357 janë të zhvendosur brenda Kosovës, 729 janë në Mal të Zi dhe 394 gjenden në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

20. UNHCR-ja ka vazhduar përkrahjen e qytetarëve të komuniteteit ashkali, egjiptas dhe atij rom në Kosovë me rastin e marrjes së dokumenteve civile dhe zgjidhjes së çështjeve të gjendjes civile, gjë që në mes të tjerash mundëson edhe qasjen në shërbime publike. Gjatë periudhës raportuese, UNHCR-ja u ka ndihmuar 105 individëve në marrjen e dokumentacionit civil.

21. Më 19 prill, UNMIK-u organizoi një tryezë të rumbullakët në komunën e Novobërdës lidhur me rolin e gruas në proceset e ndërtimit të besimit, ku morën pjesë 17 gra serbe dhe shqiptare të Kosovës nga kjo komunë. Diskutimi u fokusua në avancimin e rolit të gruas në komunë dhe në nevojën e përmirësimit të komunikimit dhe besimit mes komuniteteve.

## **VI. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut**

22. Gjatë periudhës raportuese, të akuzuarit kryesorë në dy rastet e korrupsionit dhe krimet të organizuar janë liruar nga akuzat. Më 15 maj, Gjykata e Apelit liroi nga akuzat ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe ish rektorin e Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, për bashkëfajësi në mashtrim. Më 6 qershor, Gjykata themelore e Prishtinës liroi nga akuzat për keqpërdorim të detyrës zyrtare ish-sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj. Këto lirime nga akuzat janë bërë për shkak të mungesës së provave. Para kësaj date, më 10 prill janë falur 14 të burgosur, duke përfshirë edhe 2 persona të dënuar për vrasje të rëndë.

23. Gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur edhe dy zhvillime të rëndësishme lidhur me krimet e pretenduara të luftës. Më 26 prill, një prokuror i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës ka ngritur akuzë kundër pjesëtarit të rezervistëve të policisë së Jugosllavisë apo njësitit paramilitar, Darko Tasiq, për bashkëfajësi të pretenduar në krimet e luftës kundër civilëve në fshatin Krushë e

Vogël, të bëra në mars të vitit 1999. Më 11 qershor, Gjykata Kushtetuese e Kosovës urdhëroi gjykatën themelore në Mitrovicë që të rigjykoj rastin kundër 10 ish-pjesëtarëve të “Grupit të Drenicës” të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët ishin dënuar për krime kundër civilëve gjatë viteve 1998 dhe 1999. Gjykata Kushtetuese dërgoi rastin për rigjykim pas përcaktimit se e drejta e të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur në instancën e parë.

24. Gjykata themelore e Prishtinës e përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it, më 24 maj ka shpallur vendimin për rigjykimin e rastit “Medicus”. Pronari i klinikës Medicus, Lutfi Dervishi, është shpallur fajtor për trafikim të personave dhe krim të organizuar, me ç’rast është dënuar me 7.5 vite burg dhe gjobë prej 8000 euro. Anestezilogu, Sokol Hajdini, është dënuar me një vit burg për “lëndim të rëndë trupor”.

25. Gjatë kësaj periudhe raportuese gjithashtu ka pasur zhvillime edhe në Dhomat e Specializuara të Kosovës. Emërimi i Xhek Smith (Jack Smith) si prokuror i specializuar është publikuar më 7 maj, ndërsa emërimi i Pietro Spera si Ombudsperson është shpallur më 18 maj. Raporti i parë i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar është publikuar më 14 qershor. Në raport theksohen të arriturat nga prilli i vitit 2016 deri në shkurt 2018, si dhe përshkruhet procesi i krijimit të kornizës rregullative të Dhomave të Specializuara, i fuqizimit të komunikimit dhe i themelimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

26. Deri më sot, ende mbesin 1,647 persona të zhdukur pas konfliktit të viteve 1998–1999 në Kosovë. Më 16 maj, EULEX-i dhe Instituti i Kosovës për Mjekësi Ligjore ka kryer vlerësimin e një lokacioni të varrezës masive në Gjakovë. Nga ky lokacion janë zhvarrosur pesë mbetje mortore dhe deri në fund të kësaj periudhe raportuese testet e ADN-së kanë qenë në zhvillim e sipër.

27. Me përkrahjen e Qendrës së Resurseve për Persona të Zhdukur, e cila është themeluar me ndihmën e UNMIK-ut, më 21 maj Komisioni për Persona të Zhdukur i Qeverisë së Kosovës emëroi Millorad Trifunoviçin si përfaqësues të familjeve të personave të zhdukur nga komunitetit joshumicë. Përfshirja e komuniteteve joshumicë në Komision do të ndihmojë në sigurimin e pjesëmarrjes së tyre gjatë procesit të qartësimin të fatit të personave të zhdukur pas konfliktit në Kosovë.

28. Në maj, Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave – UN Women, së bashku me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), themeluan Qendrën e Resurseve për Drejtësi Tranzicionale në Universitetin e Prishtinës, Qendër e parë kjo e këtij lloji në Kosovë. Kjo Qendër ka për qëllim avancimin e paqëndrimit, pajtimit dhe rolit të arsimit në proceset e drejtësisë tranzicionale, me fokus në qasjet me aspekte gjinore.

29. Fondacioni Jahjaga, me përkrahje të UNMIK-ut, UN-Women dhe UNDP-së, filloi zbatimin e projektit për luftimin e stigmatizimit të të mbijetuarave të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në Kosovë. Nga data 22-24 qershor, Fondacioni ka organizuar takimin e 200 viktimave të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin nga Kosova dhe Shqipëria, duke përfshirë edhe viktimat nga komunitetet joshumicë. Në kuadër të këtij organizimi të financuar nga UNMIK-u u shqyrtuan mënyrat për ndihmesën e viktimave dhe u ofrua mundësia e përkrahjes së tyre pa pasur frikë nga stigmatizimi. UNMIK-u do të vazhdojë trajtimin e nevojave sociale, psikologjike dhe ekonomike të viktimave të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, duke përkrahur organizatat lokale.

30. Më 27 prill, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë nxori raportin për rastin e gjashtë shtetasve turq, të cilët autoritetet kosovare i kishin arrestuar dhe dëbuar në Turqi më 29 mars. Në raport vihet në përfundim se institucionet e Kosovës kishin shkelur Kushtetutën gjatë arrestimit dhe dëbimit të shtetasve turq.

## VII. Gratë, paqja dhe siguria

31. Në kuadër të përpjekjeve të tij për avancimin e rolit të grave në ndërtimin e besimit, më 15 dhe 16 maj UNMIK-u mbështeti konferencën për rolin e grave në proceset e ndërtimit të besimit, të organizuar prej dy organizatave joqeveritare nga Mitrovica e Jugut dhe e Veriut. Rreth 40 pjesëmarrës të komuniteteve lokale diskutuan për sfidat dhe mundësitë e femrave në arritjen e barazisë gjinore. Ngjashëm me këtë, më 1 dhe 2 qershor, UNMIK-u në bashkëpunim me UNDP-në dhe me Programin e Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore, përkrahen një punëtori lidhur me planifikimin dhe buxhetimin gjinor në nivel komunal për grupin e grave të Kuvendit Komunal të Zveçanit. Kjo punëtori, ku morën pjesë edhe këshilltarët komunalë dhe zyrtarët e komunës me shumicë serbe të Zveçanit dhe të komunës me shumicë shqiptare të Kamenicës, dha mundësinë për komunat me shumicë shqiptare dhe ato me shumicë serbe që të këmbëjnë informatat dhe përvojat.

32. Më 14 qershor, UN-Women bashkoi deputetet femra të Kuvendit të Serbisë dhe atij të Kosovës, si dhe vendimmarrëset femra nga Evropa Juglindore në një tryezë të rrumbullakët regjionale për gratë, bashkëpunimin regjional dhe integrimet evropiane. Ato identifikuan mënyrat që gratë të luajnë rol qendror në ndërtimin e paqes, posaçërisht lidhur me Marrëveshjen e Brukselit.

## VIII. Partneriteti dhe bashkëpunimi

33. UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kosovës të Kombeve të Bashkuara, vazhduan së zbatuari të aktiviteteve programatike në fushën e sundimit të ligjit, ndërtimit të besimit mes komuniteteve, të drejtave të njeriut, fuqizimit të rinisë dhe të çështjeve gjinore. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve mbështetën përkrahjet për zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën themelore të Mitrovicës, duke sponsorizuar praktikantët juristë shqiptarë dhe serbë të Kosovës. UNMIK-u dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve gjithashtu ishin partnerë në ofrimin e pajisjeve për përkthim simultan këtyre dy gjykatave në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me të drejtat gjuhësore, sfidë kjo kryesore në procesin e integritit të gjyqësorit. Në kuadër të aktiviteteve të tjera ishte edhe ofrimi i ndihmesës teknike për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovën veriore dhe zbatimin e shtatë projekteve për rritjen e kapacitetit të policisë së Kosovës në përcjelljen e gjendjes së sigurisë dhe trajtimin e shqetësimeve të sigurisë nëpër qytete.

34. Nga data 27 deri më 29 prill, UNMIK-u dhe Grupi Veprues i Rinisë së Kosovës i bashkuan anëtarët e këshillave lokalë të veprimit të rinisë nga 20 komuna të Kosovës me qëllim të hartimit të strategjive të përbashkëta të avokimit. Më datat 14 dhe 15 maj, UNMIK-u, në bashkëpunim me Ekipin e Kosovës të Kombeve të Bashkuara, organizojë Kuvendin e Dytë të Rinisë së Kosovës, duke i bashkuar 120 të rinj nga të gjitha komunitetet, së bashku me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile. Pjesëmarrësit shqyrtuan zbatimin e planit të hartuar në Kuvendin paraprak të Rinisë dhe propozuan zgjidhje për çështjet rinore që u ngritën në Forumin për Ndërtimin e Paqes, të mbajtur në Lubjanë prej datës 6 deri më 8 maj.

35. Përfaqësuesi im Special për Kosovë dhe Ndihmëssekretarja e Përgjithshme për Operacione Paqeruajtëse udhëhoqën Forumin e Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Paqes, të cilin e organizoi UNMIK-u dhe Ekipi i Kosovës i Kombeve të Bashkuara, me pjesëmarrje të Bashkimit Evropian, EULEX-it dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë. Të 120 pjesëmarrësit, ku më shumë se gjysma ishin femra, përfaqësuan pjesë

të ndryshme të shoqërisë së Kosovës, duke përfshirë udhëheqës të administratave komunale, shoqërisë civile, institucioneve arsimore, organizata të grave dhe rinisë dhe të Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimeve të Kosovës. Ata identifikuan mënyrat për krijimin e një besimi më të madh mes komuniteteve në Kosovë dhe krijuan platformë për veprime të mëtejme në gjashtë fusha vijuese: (a) qeverisje të mirë dhe qasje në shërbime; (b) qasje në drejtësi; (c) ndërtim i besimit ndërjetor; (d) fuqizim ekonomik dhe mjedis; (e) media dhe komunikime dhe (f) arsim. Çështjet ndërsektorale përfshinë edhe të drejtat e njeriut, fuqizimin e gruas, rininë dhe të drejtat gjuhësore.

36. Gjatë periudhës raportuese, me përkrahje të UNMIK-ut janë zbatuar dy masa për ndërtimin e besimit. Më 21 maj, kryetari i komunës së Gjilanit, hapi solemnisht tregun e ri afër kishës ortodokse serbe në komunë, i cili pritet të rrisë tregtinë dhe ndërveprimin mes serbëve dhe shqiptarëve. Më 27 maj, rinia serbe dhe shqiptare morën pjesë në nismën e përbashkët për pastrimin e lumit në Brezovicë, në komunën e Shtërpçës, ku shfrytëzuan këtë nismë për të diskutuar mënyrat e avancimit të komunikimit mes komuniteteve. Në kuadër të vizitës në komunën e Dragashit, ku u organizuar edhe takimi me kryetarin e komunës, më 12 korrik, Përfaqësuesi im Special për Kosovë inauguroi një fushë shumëfunktionale sportive, e cila ishte ndërtuar më herët gjatë vitit 2018 me përkrahje nga UNMIK-u.

37. UNMIK-u vazhdoi me ofrimin e shërbimeve të certifikimit të dokumenteve. Gjatë periudhës raportuese, janë përpunuar 845 dokumente, duke përfshirë 543 sosh të ndërlidhura me pensionet dhe 304 me gjendjen civile, siç janë diplomat e shkollave të mesme dhe universiteteve, si dhe certifikatat e martesës, të lindjes dhe të vdekjes. UNMIK-u gjithashtu vazhdoi të lehtësojë ndërlidhjen mes autoriteteve të Kosovës dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë (INTERPOL). UNMIK-u ka pranuar dhe përpunuar 20 kërkesa për lëshimin e letërrreshtimeve ndërkombëtare.

## IX. Vrojtimet

38. E mirëpres vazhdimin e dialogut të nivelit të lartë të përkrahur nga Bashkimi Evropian në mes të Beogradit dhe Prishtinës, ku takimi i fundit u përkrah nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë më 24 qershor në Bruksel. Ndonëse ky takim nuk solli ndonjë përparim, vazhdimi i procesit të dialogut ofron një mundësi të ripërtërirë për trajtimin e dallimeve që ekzistojnë për një kohë të gjatë, që është thelbësore për cilëndo zgjidhje të qëndrueshme. Unë i inkurajoj liderët në Prishtinë dhe në Beograd të vazhdojnë angazhimin e tyre reciprok, duke përfshirë edhe implementimin e plotë të marrëveshjeve të arritura brenda kornizës së dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian.

39. Tentimi për fillimin e punimeve në zonën e mbrojtur speciale në Manastirin e Deçanit më 26 mars, janë çështje për t'u shqetësuar. Ligji për zonat e mbrojtura speciale dhe konkludimet e Këshillit për implementim dhe monitorim, të ngarkuar për mbikëqyrjen e të gjitha ndërtimeve në zonat e mbrojtura speciale dhe për menaxhimin e tyre duhet të respektohet. Përgëzoi përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare që të flasin njëzëri kundër shkeljeve të mundshme.

40. Theksoj me shqetësim gjithnjë e më të madh se, pas gjashtë muajsh, hetimi për vrasjen e politikanit serb të Kosovës Olliver Ivanoviq, më 16 janar, në pikë të ditës në Mitrovicë, mbetet i pazgjidhur. Ju bëj thirrje autoriteteve të Kosovës të intensifikojnë hetimet e tyre, duke shfrytëzuar të gjitha kanalet e mundshme për ndihmë.



41. Me përfundimin e funksioneve gjyqësore ekzekutive të EULEX-it dhe largimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë nga Kosova, autoritetet e Kosovës së shpejti do të jenë përgjegjëse për të gjitha hetimet, për ndjekjet penale dhe për gjykimin e krimeve të rënda. Policia e Kosovës, prokurorët, avokatët mbrojtës, gjyqtarët dhe personeli tjetër i gjykatave, do të kenë nevojë për mbështetje për trajtimin e një numri të madh të lëndëve të pazgjidhura, duke përfshirë edhe qindra lëndë të krimeve të luftës. Po theksoj se një gjyqësor i pavarur, efikas dhe profesional është thelbësor për zgjidhjen paqësore të kontesteve dhe besimit publik në administrimin e drejtësisë.

42. Vlerësoj deklaratat e fuqishme të liderëve politikë në Prishtinë si reagim ndaj disa krimeve të konsideruara etnikisht të motivuara. Pavarësisht nga motivet e incidenteve individuale, besimi publik në objektivitetin dhe efikasitetin e institucioneve kërkon lidërsip të tillë aktiv.

43. Përgëzoj të gjithë pjesëmarrësit në Forumin e Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit në Kosovë, të drejtuar nga Përfaqësuesi im Special për Kosovë dhe Ndihmëssekretarja e Përgjithshme për Operacione Paqeruajtëse, të mbajtur nga data 6 deri më 8 maj. Ata kanë përgatitur një listë ambicioze të rekomandimeve në fushat e identifikuar prioritare, dhe unë pres angazhim aktiv të të gjitha palëve në fjalë, duke përfshirë edhe Kombet e Bashkuara, në realizimin e plotë të këtyre rekomandimeve.

44. Unë e përsëris thirrjen time për të kontribuar në fondin e mirëbesimit për mbështetjen e komunitetit ashkali, egjiptian dhe atij rom që janë prekur nga helmimi me plumb në Kosovë. Kontributet në këtë fond të mirëbesimit do të përkrahin implementimin e projekteve që trajtojnë nevojat më urgjente të këtyre komuniteteve të cënueshme, duke përfshirë fushën e shëndetësisë, të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës.

45. Unë e falënderoj Përfaqësuesin tim Special për Kosovë dhe stafin e UNMIK-ut për energjinë, për kreativitetin dhe për përkushtimin që e kanë dedikuar në punën e Misionit. Unë po ashtu falënderoj përkushtimin e treguar nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovë, nën drejtimin e koordinatorit për zhvillim që posa ka arritur, dhe përpjekjet e tij të shtuara për të bashkëpunuar me UNMIK-un që të veprojnë si “një KB”. Gjithashtu, unë theksoj dhe vlerësoj që Bashkimi Evropian dhe autoritetet e Kosovës janë pajtuar për fazën e ardhshme të punës së EULEX-it. Së fundi, e përsëris falënderimin tim për partnerët e kamotshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, përkatësisht Forcën e Kosovës (KFOR), praninë e Bashkimit Evropian dhe OSBE-në, për punën e tyre të shkëlqyeshme ekipore dhe për bashkëpunimin me UNMIK-un.

## Shtojca I

### **Raporti i Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 16 prilli deri më 15 korrik 2018**

#### 1. Përmbledhje

Më 14 qershor, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) përmbushi mandatin e tij dyvjeçar dhe pranoi mandatin e ri deri më 14 qershor të vitit 2020. Ky Mision do të vazhdojë të përkrahë institucionet relevante të sundimit të ligjit në rrugëtimin e tyre për rritjen e efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe përgjegjshmërisë, pa ndërhyrje politike dhe në përputhshmëri të plotë me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian. Derisa gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it janë tërhequr nga sistemi vendor i drejtësisë, ky Mision do të monitorojë lëndë dhe gjykime të përzgjedhur në fushën e drejtësisë penale dhe civile në Kosovë dhe do të vazhdojë të monitorojë, të drejtojë dhe këshillojë Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Procesi i përzgjedhjes për pozita të larta në gjyqësor vazhdon të paraqesë sfida. Mirëpo, ka pas përmirësime në efikasitetin e sistemit të gjykatave, posaçërisht në rritjen e caktimit të seancave dëgjimore.

Brenda aktiviteteve të tij monitoruese, drejtuese dhe këshilluese, ky Mision vazhdoi të përqendrojë përpjekjet e tij veçanërisht në Shërbimin Korrektues të Kosovës, i cili po ashtu ka pësuar nga ndërhyrjet politike dhe trajtimin e privilegjuar të një grupi të caktuar të të burgosurve të profilit të lartë.

EULEX-i po ashtu ka ofruar monitorimin, drejtimin dhe këshillimin për hetimin e vrasjes së politikanit të spikatur serb të Kosovës, Olliver Ivanoviq.

#### 2. Aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

##### 2.1. Ekzekutivi

###### *Krimi i organizuar dhe korrupsioni*

Më 17 prill, një prokuror i EULEX-it ngriti aktakuzë në gjykatën themelore të Mitrovicës kundër gjashtë të pandehurve të akuzuar për posedimin e paautorizuar të armëve, mundësimin apo detyrimin në prostitucion, ushtrimin e ndikimit, mashtrimin dhe falsifikimin e dokumenteve.

Më 24 maj, një panel i përbërë prej një gjyqtari vendor dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it, e shpallën vendimin e tyre në gjykatën themelore në Prishtinë kundër dy të pandehurve në rastin “Medicus” për trafikimin e organeve njerëzore. Një i pandehur u shpall fajtor për krim të organizuar në lidhje me trafikimin e personave dhe u dënua me 7.5 vite burgim dhe gjobë prej 8,000 eurosh. Tjetri u shpall fajtor për lëndime të rënda trupore dhe u dënua me një vit burgim.

Më 8 qershor, Gjykata Kushtetuese nxori aktvendim duke shpallur aktgjykimin e Gjykatës Supreme të pavlefshëm në rastin e ashtuquajtur “Drenica II”, në të cilin të pandehurit e profilit të lartë ishin shpallur fajtor për krime lufte. Gjykata Kushtetuese vendosi se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat e të pandehurit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe urdhëroi që lëndë të kthehet në Gjykatën Supreme për rishqyrtim. Dy gjyqtarët e EULEX-it patën mendim të përbashkët pakënaqësie duke shprehur mospajtimin e tyre me shumicën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

### *Krimet e luftës*

Më 26 prill, një prokuror i EULEX-it ngriti aktakuzë kundër një të pandehuri në gjykatën themelore të Prizrenit të akuzuar për kryerjen e krimeve të luftës në fshatin Krushë e Vogël, nga data 25 deri më 27 mars 1999.

Më 16 maj, një panel i përbërë prej tre gjyqtarëve të EULEX-it në gjykatën themelore në Mitrovicë, nxori vendim për një lëndë të krimeve të luftës kundër një të pandehuri. Panel e liroi të pandehurin nga të gjitha akuzat meqë nuk mund të dëshmohej se ai kishte kryer aktet për të cilat akuzohej. Më 25 maj, një panel prej tre gjyqtarëve të EULEX-it shpalli vendimin e tij në gjykatën themelore në Mitrovicë për një lëndë tjetër të krimeve të luftës kundër të pandehurit të njëjtë. Paneli e shpalli të pandehurin fajtor për një pikë të akuzës për krime lufte, me të cilën ishte ngarkuar, dhe e dënoi me 6.5 vite burgim.

### *Dorëzimi i lëndëve dhe i dosjeve të lëndëve*

EULEX-i vazhdoi dorëzimin e lëndëve, dosjeve të lëndëve dhe dëshmiave institucioneve relevante të Kosovës. Prokurorët e EULEX-it ia dorëzuan lëndët dhe dosjet e lëndëve Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe prokurorisë themelore në Mitrovicë. Ndërkohë, gjyqtarët e EULEX-it vazhduan dorëzimin e lëndëve homologëve të tyre vendorë.

### *Instituti i mjekësisë ligjore*

Nga data 16 prill deri më 16 maj, ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it kryen një zhvarrosje në Gjakovë. U gjetën gjashtë mbetje trupore.

EULEX-i mundësoi mbajtjen e një punëtorie për prokurorët e Kosovës lidhur me shkathësitë e teknikave të marrjes në pyetje për dëshmitarët dhe viktimat e krimeve të luftës, me fokus në lëndët e dhunës seksuale dhe ato në baza gjinore.

EULEX-i organizoi një punëtori trajnimi që synonte avancimin e kapacitetit të prokurorëve vendorë në punën e tyre të përbashkët me policinë dhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese në Mitrovicë, për të dënuar dhe hetuar korrupsionin dhe krimet e ngjashme.

EULEX-i, së bashku me policinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, mbajtën një kurs për rendin publik dhe sigurinë publike në rast të emergjencave për policët e Kosovës.

EULEX-i përkrahu takimin e dytë nga një sërë takimesh të grupit punues operacional për bashkëpunimin në mes të policisë, prokurorëve dhe ekspertëve të mjekësisë ligjore për lëndët e dhunës seksuale dhe ato në baza gjinore, të kryesuar nga kryeprokurori i prokurorisë themelore të Ferizajt.

## **2.2. Fuqizimi**

### *Monitorimi i lëndëve*

Akoma ka sfida për efikasitetin e sistemit të gjykatave, posaçërisht në fushat e shtyrjeve të atypëratyshme të seancave dëgjimore, fillimet e vonshme dhe seancat e prolonguara padrejtësisht, shpesh për shkak të moslajmërimit të palëve dhe mungesës së paarsyetuar të tyre, duke rezultuar me seanca dëgjimore joproduktive, përkatësisht me seanca ku asgjë e rëndësishme nuk ndodh. Mirëpo, gjatë muajve të kaluar, përqindja e seancave dëgjimore joproduktive ka rënë mesatarisht, dhe ka pas një rritje të përgjithshme të caktimit të seancave dëgjimore.

### *Gjyqësori*

Procesi i përzgjedhjes për pozita të larta në gjyqësor vazhdon të paraqesë sfida të shumta. Më 30 maj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emërtoi gjyqtar mbikëqyrës për degën e Kamenicës dhe Novobërdës të gjykatës themelore të Gjilanit, si dhe për degën e Leposaviqit në gjykatën themelore të Mitrovicës. Gjithashtu caktoi një ushtrues detyre të gjyqarit mbikëqyrës për degën e Zubin Potokut të gjykatës themelore të Mitrovicës. EULEX-i shprehu shqetësimet e tij për procesin e përzgjedhjes, meqë Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk e morri parasysh rregulloren në fuqi dhe nuk diskutoi publikisht vlerësimet e kandidatëve para se të vazhdojnë me procesin e votimit.

Sfidat tjera janë nevoja për tejkalimin e mospërputhjeve dhe kundërtënieve në kornizën legjislative për gjyqësorin, reforma për procedurë disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe integrimin e gjyqësorit në veri. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligji për gjykatat janë ndryshuar dy herë që nga miratimi i tyre në vitin 2010, një herë në vitin 2015 dhe herën tjetër në vitin 2018, duke kërkuar hartimin e rregulloreve të reja që kanë të bëjnë me amendamentet aktuale të pazgjidhura, si dhe ndryshimet tjera në rregulloret ekzistuese.

Më 6 qershor, Kuvendi i Kosovës e miratoi draftin e kodit penal në leximin e parë, kurse rishqyrtimi i kodit të procedurës penale akoma është duke vazhduar në Ministrinë e Drejtësisë. Përfundimi i procesit të ndryshimit të kornizës ligjore penale, përkatësisht i kodit penal dhe i kodit të procedurës penale, i Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe i ligjeve të tjera të ndërlidhura në këtë proces, është i një rëndësie të madhe në tejkalimin e pengesave për implementimin praktik të legjislacionit dhe bashkimin e tij me legjislacionin dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe instrumentet tjera të së drejtës ndërkombëtare. Përmes mekanizmit të rishikimit legjislativ, EULEX-i ka ofruar komente të rëndësishme për kornizën, duke propozuar amendamente konkrete për dispozitat ekzistuese, me arsyetim të detajuar për çdo propozim.

Puna e dobët e zyrës së këshillit disiplinor dhe mungesa e përgjegjshmërisë ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës ka rezultuar në nevojën për reformim të sistemit disiplinor. Për këtë arsye, EULEX-i ka rekomanduar që implementimi i Ligji për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të monitorohet për së afërmi, me fokus të veçantë në kalimin në sistemin e ri dhe dosjet e lëndëve që janë në vazhdim e sipër.

Sa i përket integritit të gjyqësorit në veri, sfidat kryesore janë përmirësimi i kushteve të punës, duke përfshirë edhe rekrutimin e një numri të mjaftueshëm të përkthyesve dhe interpretëve që zotërojnë gjuhën shqipe dhe serbe, dosjet e lëndëve të pranuar nga sistemi paralele dhe implementimi i konkluzioneve që plotësojnë Marrëveshjen e parë të parimeve që drejtojnë normalizimin e marrëdhënieve.

### *Shërbimi Korrektues i Kosovës*

Më 27 prill, u emërtua drejtor i ri i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, një zhvillim i rëndësishëm duke marrë parasysh se nuk kishte pasur drejtor të përgjithshëm të përhershëm që nga viti 2015. Procesi i përzgjedhjes, i monitoruar nga EULEX-i, u zhvillua në përputhje me procedurat dhe kushtet relevante. Plotësimi i vendeve me personel dhe riorganizimi i personelit paraqesin një problem të madh për efikasitetin e Shërbimit Korrektues të Kosovës. Pas shumë vitesh ku një numër i konsiderueshëm i personelit kanë pasur pozita të ushtruesit të detyrës, Shërbimi Korrektues i Kosovës më në fund shpalli konkurs të brendshëm të vendeve të lira në maj për udhëheqës, udhëheqës të lartë dhe shefa të njësive. Procesi i testimit dhe intervistimit është duke vazhduar.

Duke pas parasysh mungesën e përfaqësimit të femrave në nivelin drejtues në Shërbimin Korrektues të Kosovës, EULEX-i organizoi një punëtori dyditore më 28 dhe 29 maj për 50 zyrtare korrektuese femra, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të tyre, duke diskutuar rolet e tyre dhe sfidat dhe duke i inkurajuar të aplikojnë për pozita më të larta.

Lidhur me trajtimin e privilegjuar të një grupi të caktuar të të burgosurve të profilit të lartë, EULEX-i monitoroi disa hospitalizime të një të burgosuri të njohur të profilit të lartë gjatë muajit prill dhe maj, duke konstatuar shkallë të ndryshueshme të profesionalizmit dhe të zbatimit të masave të sigurisë dhe standardeve, varësisht nga zyrtari i Shërbimit Korrektues të Kosovës në detyrë.

Pas informacioneve të EULEX-it për problemin e vazhdueshëm të kontrabandimit në qendrën korrektuese të Dubravës, u intensifikuan operacionet e kërkimit, duke rezultuar në rritje të konsiderueshme të sasisë së përgjithshme të kontrabandës së gjetur. Mirëpo, që këto përpjekje të jenë të qëndrueshme për një kohë më të gjatë, Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet të ofrojë përkrahje dhe koordinim në të gjitha objektet e tij.

#### *Policia e Kosovës*

Më 17 dhe 18 maj, përfaqësues të forcave policore të Shqipërisë, Kroacisë, Sllovenisë, të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës, morën pjesë në një konferencë të shefave rajonalë të policisë në Prishtinë, të drejtuar nga Policia e Kosovës dhe të përkrahur nga EULEX-i. Kjo konferencë u organizua për të promovuar bashkëpunimin rajonal, pas konferencës së suksesshme të shefave të policisë të mbajtur në Shkup në shtator të vitit 2016. Fokusi kryesor i konferencës së fundit ishte vlerësimi i rreziqeve dhe kërcënimeve strategjike për paqen dhe stabilitetin rajonal për shkak të krimit të organizuar transnacional, terrorizmit dhe migracionit.

#### *Ngritja e kapaciteteve*

E mundësuar nga EULEX-i, Policia e Kosovës realizoi një vizitë studimore në Suedi, për të fuqizuar kapacitetin ekzekutiv të njësisë ligjzbatuese të së drejtës ndërkombëtare dhe për të avancuar punën e saj operacionale, veçanërisht kur fokusohen në mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave.

Derisa njësitë e specializuara të Policisë së Kosovës, me përkrahjen e EULEX-it, kanë arritur një nivel operacional që arrin standardet evropiane dhe ndërkombëtare të bazuara në rregulla, ende ka nevojë të ngriten kapacitetet e tyre lidhur me policimin dhe sigurinë publike në situata emergjente për ngjarje të mëdha sportive. Kjo veçanërisht është e rëndësishme për shkak të pranimit të Kosovës në Federatën Ndërkombëtare të Asociacioneve të Futbollit (FIFA) dhe në Unionin e Asociacioneve Evropiane të Futbollit (UEFA) në vitin 2016. Në përpjekje për të përkrahur Policinë e Kosovës lidhur me obligimet e tyre, veçanërisht në lidhje me nenin 2 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në prill EULEX-i përkrahu një kurs tetëditor të komandës së lartë, të prezantuar nga katër trajnerë nga Policia e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore (Policia e Linkonshajr). Komandantëve të Policisë së Kosovës u ofrua mundësia të avancojnë shkathtësitë dhe ekspertizën e tyre aktuale kur trajtojnë ngjarje spontane dhe të paraplanifikuara, që kërkojnë rend dhe siguri publike të situatave emergjente.

#### *Inspektorati i Policisë së Kosovës*

Hetimi efektiv i zyrtarëve të rangut të lartë mbetet sfidë për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, siç është rasti që po vazhdon i drejtorit të Njësisë për krime ekonomike në Policinë e Kosovës, si dhe rasti i 59 policëve të ndaluar për korrupsion

dhe i 148 policëve të cilët janë të evidentuar për mashtrim. Ngurrimi i prokurorëve të hapin lëndë kundër zyrtarëve të rangut të lartë në Policinë e Kosovës dhe proceset e ngadalta gjyqësore e rrisin numrin e lëndëve të pazgjidhura.

#### *Migrimi*

Ka shqetësime në qendrën e migrimit për mungesën e shkëmbimit të informacioneve precize dhe të detajuara në kohë reale të dosjeve penale për të kthyerit forcërisht, të cilët paraqesin rreziqe potenciale për sigurinë publike. Gjithashtu, fuqishëm rekomandohet shkëmbim më i mirë i të dhënave, ndër të tjera, me institucionet e Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ndiqen azilkërkuessit të cilët e shfrytëzojnë Kosovën si rrugë transit për të shkuar në Evropën Perëndimore. Në fushën e ligjvënies, dy ligje të rëndësishme, për të cilët EULEX-i ka këshilluar, kanë hyrë në fuqi: Ligji për të huajt, më 18 maj, dhe Ligji për azil, më 30 maj.

#### *Dialogu i përkrahur nga Bashkimi Evropian*

Ministri i ri i Punëve të Brendshme emëroi një koordinator të ri vendor për menaxhimin e integruar të kufirit, duke premtuar përparim në implementimin e strategjisë për menaxhimin e integruar të kufirit dhe planin për zhvillim për qendrën nacionale për menaxhim të kufirit.

Mirëpo, meqë nuk ka pas ndonjë aktivitet tash së fundi në dialogun e përkrahur nga Bashkimi Evropian, nuk është bërë ndonjë përparim i dukshëm për implementimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes dhe të protokollit teknik për menaxhimin e integruar të kufirit. EULEX-i vazhdoi të vizitojë të gjashtë pikëkalimet e përbashkëta në datat e takimeve të nivelit lokal dhe, edhe pse të dy palët nuk takohen formalisht, atmosfera në përgjithësi është miqësore, dhe ekziston një shkallë e bashkëpunimit operacional në të gjitha pikëkalimet e përbashkëta.

Nuk është bërë përparim lidhur me krijimin e tri pikëkalimeve të përbashkëta që duhet drejtuar nga Beogradi. Sa u përket pikëkalimeve të përbashkëta që duhet drejtuar nga Prishtina, ndërtimi i pikëkalimeve të përbashkëta në Merdare dhe Mutivodë është duke vazhduar, kurse nuk ka progres në pikëkalimin e përbashkët në Bërnjak për shkak të çështjes së pazgjidhur të zhvendosjes së linjave të energjisë elektrike.

### **3. Çështje të tjera kryesore**

Asgjë e rëndësishme për t'u raportuar.

## Shtojca II

### Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Dhomat e Specializuara vazhduan të intensifikojnë gatishmërinë e tyre për aktivitete gjyqësore në periudhën raportuese, duke rritur numrin e avokatëve në listat e avokatëve mbrojtës dhe avokatëve të viktimave deri në 89, dhe duke emërua, më 18 maj, Pietro Spera (Itali) si Ombudsperson për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, duke siguruar kështu edhe më shumë përputhshmëri me standardet më të larta të të drejtave të njeriut. Ombudspersoni ka një mandat dhe rol unik në monitorimin, mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave të cilët bashkëveprojnë me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, edhe pse ai mund të ndërhyjë në procese gjyqësore vetëm në rast të një vonese të paarsyeshme.

Dhomat e Specializuara vazhduan aktivitetet e tyre intensive të informimit për të shpjeguar mandatin e tyre dhe për të nxitur komunikim të drejtpërdrejtë me komunitetet e ndikuara. Nga 24 deri më 26 prill, përfaqësuesit e Dhomave të Specializuara udhëtuan në Kosovë për t'u angazhuar në aktivitetet e informimit me organizatat joqeveritare, me organizatat e shoqërisë civile, me gazetarë dhe me avokatë.

Në maj, pas shpalljes së listës së përditësuar të avokatëve, të gjithë avokatët e pranuar në listë u kontaktuan për t'i inkurajuar ata që shpejt e shpejt të krijojnë një organ përfaqësimi për të gjithë avokatët e pranuar të punojnë në Dhomat e Specializuara.

Nga 14 deri më 17 maj, administruesja e Dhomave të Specializuara e bëri vizitën e saj të parë zyrtare në Serbi, duke mbajtur takime me shumë organizata të shoqërisë civile dhe me partnerë potencialë. Administruesja gjithashtu informoi një sërë zyrtarësh, duke përfshirë shefin e zyrës së Kombeve të Bashkuara në Beograd, shefin e delegacionit të Bashkimit Evropian për Serbi dhe shefin e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Serbi, për progresin e bërë nga Dhomat e Specializuara dhe avancimin e aktiviteteve për informim në Serbi.

Nga 6 deri më 8 qershor, Dhomat e Specializuara mirëpritën përfaqësues nga 15 organizata joqeveritare nga Kosova dhe Serbia në një punëtori informative në Hagë. Përmes kësaj punëtorie kërkohet të merreshin reagimet nga shoqëria civile mbi programin informativ të Dhomave të Specializuara dhe të paraqiteshin ide konkrete se si të avancohej dhe tutje të zhvilloheshin aktivitetet informative në rajon.

Në qershor, Dhomat e Specializuara dhe zyra e prokurorit të specializuar e paraqitën raportin e tyre të parë, duke mbuluar periudhën nga themelimi i Dhomave të Specializuara, në prill të vitit 2016 deri në shkurt të vitit 2018. Ky raport i është vënë në dispozicion publikut në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara në shqip, anglisht dhe serbisht (me versionin cirilik që është në përgatitje e sipër).

Gjatë periudhës raportuese, gjyqtarët e Dhomave të Specializuara vazhduan përgatitjet për aktivitetet e ardhshme gjyqësore. Nga prilli deri në qershor, një grup punues prej tre gjyqtarësh i Dhomave të Specializuara përgatiti dokumentin e gjelbër për menaxhimin efikas të procedurave, duke u përqendruar në rolin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve në menaxhimin e procedurave, çështjet e menaxhimit të lëndëve që paraqiten gjatë fazave të ndryshme të procedurës dhe menaxhimin efikas të çështjeve konkrete procedurale. Të gjithë gjyqtarët bënë komente të rëndësishme për dokumentin e gjelbër. Gjithashtu, një gjyqtar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Kushtetuese, në konsultim me tre gjyqtarët e tjerë, përgatitën një dokument të gjelbër për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duke identifikuar praktika gjyqësore të Kosovës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që janë

relevante për punën e Dhomave të Specializuara. Ky dokument i gjelbër më vonë u nda me të gjithë gjyqtarët.

Më 8 qershor, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi buxhetin e ardhshëm për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar përmes dhurimit të një granti Dhomave të Specializuara, të cilin administruesja e nënshkroi më 25 qershor. Me vendimin e tij, Këshilli siguron buxhet dyvjeçar deri më 14 qershor 2020, dhe jo buxhet vjetor.

Më 11 dhe 12 qershor, në mënyrë që të avancojnë njohuritë e tyre ligjore, gjyqtarët morën pjesë në një simpozium të drejtuar në bashkëpunim me Ecole nationale de la magistrature në Paris. Prezantimet nga folësit e jashtëm dhe diskutimet e mëvonshme u fokusuan në tema relevante për punën e ardhshme gjyqësore të Dhomave të Specializuara.

Më 26 qershor, në përpjekje për të siguruar kapacitete të avancuara të personelit, Dhomat e Specializuara e mbyllën shpalljen e fundit për 59 pjesëtarë të ri të personelit për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe menjëherë filluan fazat e ardhshme të procesit të rekrutimit, me qëllim të pozicionimit të shpejtë të personelit të nevojshëm.

Nga 9 deri më 12 korrik, përfaqësuesit nga Dhomat e Specializuara udhëtuan në Kosovë për t'u angazhuar në aktivitetet e informimit, duke përfshirë edhe një tryezë të rrumbullakët me gazetarë, takime me organizata të shoqërisë civile dhe një ngjarje përditësuese mbi aktivitetet informative për komunitetin diplomatik. Dhomat e Specializuara drejtuan 17 vizita grupe në Hagë përmes programit të tyre të vizitorëve.

Dhomat e Specializuara vazhduan të punojnë me shtetin nikoqir në mënyrë që të mundësojnë punën e tyre, duke përfshirë edhe renovimin e hapësirave të gjykatës në Hagë.

Puna e Dhomave të Specializuara me shtete anëtare të Bashkimit Evropian veç e veç, me shtetet e treta kontribuuese dhe me shtetet e tjera, ende vazhdon dhe është shumë e përqendruar në marrjen e mbështetjes për bashkëpunim mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe zbatimin e dënimeve.

Një prokuror nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Xhek Smith, i cili ka përvojë në hetime politike të nivelit të lartë dhe në hetime penale ndërkombëtare, u emërua si Prokuror i Specializuar më 7 maj, pas një procesi përzgjedhës të organizuar nga Bashkimi Evropian. Ai e zëvendësoi Dejvid Shvendiman (David Schwendiman), Prokurorin e parë të Specializuar që më parë ka qenë prokuror kryesor në grupin vepruese special hetimor, i cili e la këtë post në fund të marsit, kur skadoi mandati i tij si zyrtar i lartë për Punë të Jashtme në Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara. Z. Smith është caktuar të merr detyrën në gusht. Ndërkohë, Zëvendësprokurori i Specializuar, Kwai Hong Ip, ka drejtuar hetimin për pretendimet e përfshira në raportin e janarit të vitit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të quajtur "Trajtim johuman i njerëzve dhe trafikim i paligjshëm i organeve njerëzore".

Sipas ligjit special, Dhomat e Specializuara kanë epërsi mbi të gjitha gjykatat tjera në Kosovë. Prokurori i Specializuar, në mes tjerash, ka autoritetin të ftojë institucionet e Kosovës ta ndihmojnë atë. Përveç kësaj, EULEX-i, sipas mandatit të ri, i ofron mbështetje logjistike dhe operacionale Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Me avancimin e hetimeve, ndihma e tillë, si dhe ajo nga autoritetet e Beogradit, Bashkimit Evropian dhe komunitetit të gjerë ndërkombëtarë do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Zyra e Prokurorit të Specializuar ka nevojë për angazhim të vazhdueshëm dhe për përkrahje të plotë të bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe të shteteve individuale në të gjitha aktivitetet e saj.



### Shtojca III

#### **Përbërja dhe fuqia e komponentës së policisë të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

(nga 15 korrik 2018)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Austria	1
Bullgaria	1
Finlanda	1
Gjermania	1
Hungaria	2
Federata Ruse	2
Turqia	1
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>

#### **Përbërja dhe fuqia e komponentës ndërlidhëse ushtarake të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**

(nga 15 korrik 2018)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Çekia	2
Polonia	1
Republika e Moldavisë	1
Rumania	1
Turqia	1
Ukraina	2
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>



Map No. 4193 Rev. 76 UNITED NATIONS  
July 2018 (Colour)

Department of Field Support  
Geospatial Information Section (formerly Cartographic Section)